



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-123
Prishtinë, më 19 tetor 2010, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 19 TETOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, Slllobodan Petroviq dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Xhezair Murati dhe Branisllav Grbiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Ismet Hajrullahu, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga ZCN, Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE, Floriana Shala dhe
Nga NDI, Rinor Beka.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari, hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 tetor 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 tetor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 tetor 2010, u miratuar pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 28 tetor 2010, me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia ndaj palëve të treta,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisjen lokale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjendjen civile,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës,
9. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve të Republikës së Kosovës për periudhën 2011-2013,
10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Driton Tali lidhur me garancinë bankare të operatorit mobil “Kosmocell”, dhe
11. Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës, për vitin 2009.

Gjithashtu, Kryesia vendosi që edhe projektligjet e tjera që përgatiten ndërkohë për shqyrtim të dytë, të radhiten në rend dite të mbledhjes plenare më 28 tetor 2010.

Kryesia, në pajtim me nenin 56.2 të Rregullores së Kuvendit, caktoi komisionet funksionale raportuese që t'i shqyrtojnë projektligjet dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet preliminare, para shqyrtimit të tyre, në parim.

Kryesia caktoi këto komisione:

Komisionin për Buxhet dhe Financa, që ta shqyrtojë Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta;

Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, që ta shqyrtojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisjen lokale;
Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, që ta shqyrtojë Projektligjin për gjendjen civile;
Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, që ta shqyrtojë Projektligjin për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Kërkesa e ish-deputetit Xhelal Canziba për kompensimin e shpenzimeve për mjekim

Kryesia, pasi e rishqyrtoi kërkesën e ish-deputetit Xhelal Canziba për kompensimin e shpenzimeve për mjekim, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit konstatoi se në mungesë të mjeteve nga ndonjë linjë buxhetore e Kuvendit për këtë destinim, t'i rekomandohet sërish Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë që nga Fondi i mjeteve të destinuara për shërimin e pacientëve jashtë vendit, t'ia kompensojë shpenzimet e shërimit ish - deputetit Xhelal Canziba.

3.2 Kërkesa e deputetes Sala Berisha-Shala, për kompensimin e mëditjeve shtesë lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Turqi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e deputetes Sala Berisha-Shala, për kompensimin e mëditjeve shtesë lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Turqi, nxori këtë

V E N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk miratoi kërkesën e deputetes Sala Berisha-Shala, për kompensimin e mëditjeve shtesë lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar, me ftesë të Internacional Mineral Processing, që ka marr pjesë në Simpoziumin e XII të mbajtur në Turqi, nga data 5 deri 10 tetor 2010, me arsyetimin se kërkesa nuk është në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 03-V-094.

3.3 Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin vjetor të BQK-së

Kryesia, pasi e shqyrtoi njoftimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin vjetor të BQK-së, për vitin 2009, vendosi që kjo pikë të radhitet për mbledhjen plenare më 28 tetor 2010.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale